

RREGULLORJA E VLERËSIMIT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR TEK NEHEMIAH GATEWAY ALBANIA

2020 – xxxx NG TEAM

© Fondacioni Nehemiah Gateway Albania 2020

Versioni 12.10.2020

Neni 1 Baza ligjore.....	3
Neni 2 Vlerësimi i nxënësve	3
Neni 3 Vlerësimi i nxënësit në arsimin parauniversitar	3
Neni 4 Testimet për të evidentuar arritjet e nxënësve	3
Neni 5 Sesionit i dytë	3
Neni 6 Mbetja në një lëndë, mbetja në klasë, përsëritja e klasës	4
Neni 7 Vlerësimi me notë	4
Neni 8 Arsimi fillor	4
Neni 9 Vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët	5
Neni 10 Vlerësimi i sjelljes së nxënësit	6
Neni 11 Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë	6
Neni 12 Matura	7
Neni 13 Publikimi i rregullores	7
Neni 14 Hyrja në fuqi.....	7

Neni 1 **Baza ligjore**

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 57
2. Ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë “Ligji”),
3. Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë Ligji Nr.7961 datë 12.07.1995, të përditësuar.
4. Urdhërin nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë
5. aktet nënligjore në fuqi dhe me këtë rregullore.
6. Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar
7. Standartet e të nxënësit,
8. Programet lëndore,

Neni 2 **Vlerësimi i nxënësve**

1. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënësit, duke u bazuar në nivelet e arritjes.
2. Qëllimi kryesor i vlerësimit është të mbështesë të nxënësit dhe përparimin e nxënësit.

Neni 3 **Vlerësimi i nxënësit në arsimin parauniversitar**

1. Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III bëhet me përshkrim.
2. Vlerësimi i nxënësit për arritjen e kompetencave të fushave/lëndëve të të nxënësit në klasat IV-XII bëhet me notë dhe realizohet me:
 - a) Vlerësimin e vazhduar;
 - b) Vlerësimin me test ose me detyrë përmbledhëse;
 - c) Vlerësimin e portofolit të nxënësit.
3. Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë, referuar niveleve të arritjes.
4. Nota përfundimtare përfshin notat vjetore si më poshtë:
 - a) Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudhat;
 - b) Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse për tri periudhat;
 - c) Notën vjetore të vlerësimit të portofolit të nxënësit për tri periudhat.
5. Mësuesi mban të dhëna gjatë vitit shkollor për vlerësimin e nxënësit. Vlerësimi i vazhduar, testet/detyrat përmbledhëse dhe portofoli i nxënësit ruhen në shkollë dhe janë objekt monitorimi në çdo periudhë të vitit shkollor.

Neni 4 **Testimet për të evidentuar arritjet e nxënësve**

1. Drejtorja e institucionit arsimor organizon testime të jashtme për të gjitha lëndët ose fushat e të nxënësit dhe të gjitha klasat, për të evidentuar arritjet e nxënësve në një periudhë të caktuar.
2. Procedurat, periudha dhe numri i testimeve caktohen nga drejtorja.

Neni 5 **Sesioni i dytë**

1. Nxënësi vlerësohet në sesionin e dytë, kur është jokalues në një ose dy lëndë.
2. Mësuesi i klasave IV-V i jep nxënësit detyra konkrete për t'i zhvilluar gjatë verës dhe në sesionin e dytë vendos kalimin ose jo të nxënësit.
3. Mësuesi i arsimit të mesëm i jep nxënësit detyra konkrete dhe një program orientues për t'u parapërgatitur. Nxënësi i nënshtrohet provimit me shkrim të hartuar nga mësuesi i lëndës dhe të miratuar nga ekipi lëndor. Vlerësimi i tij bëhet nga komisioni i ngritur nga drejtori, i përbërë nga tre anëtarë.

4. Kur nxënësi nuk paraqitet në provim për arsye të dokumentuara ligjërish, drejtori i IA-së cakton një datë tjetër brenda sesionit të dytë.

Neni 6

Mbetja në një lëndë, mbetja në klasë, përsëritja e klasës

1. Vendimi për përcaktimin jokalues të nxënësit në një lëndë, me përjashtim të klasave I-III, e merr mësuesi i klasës/lëndës.
2. Nxënësi është mbetës në klasë, kur:
 - a) Është jokalues në të paktën tri lëndë;
 - b) Është jokalues të paktën në një lëndë në sesionin e dytë;
 - c) Ka masën disiplinore "Ulje e notës në sjellje" dhe nuk e ka përmirësuar atë deri në përfundim të vitit mësimor.
 - d) Figuron i paklasifikuar për shkak të mungesave.
3. Nxënësi mbetës e përsërit klasën në vitin shkollor pasues, kur është brenda moshës së përcaktuar në Ligjin e Arsimit Parauniversitar.

Neni 7

Vlerësimi me notë

1. Vlerësimi vjetor me notë mbështetet si më poshtë:
 - a) 50% çdo vit të paktën 2 punë krahasuese të jashtme (një në fund të semestrit të parë dhe një në fund të vitit) nga MASR ose nga shkollat partnere (Drejtuesi Didaktik Pedagogjik)
 - b) 30 % vlerësimi në provimet e kapitujve në lëndët kryesore duke lajmëruar të paktën 2 javë më parë
 - c) 20 % vlerësimi i projekteve kurrikulare, si dhe vlerësimi me gojë.
2. Gjithashtu bëhet një përshkrim i detajuar i sjelljes sociale, i talentit të nxënësit dhe rezultateve të tij për çdo lëndë.
3. Kopjimi nga nxënësit e tjerë ka si rezultat vënien e notës 4.
4. Gjatë hartimit dhe organizimit të punës, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe faktit që mund të ketë dhe vështirësi.
5. Provimet duhet të organizohen në mënyrë të tillë, që të vendosen të gjitha notat për të garantuar një diferencim dhe nxitje të nxënësve. Vlerësimi duhet të luhatet tek mesatarja e notave. Prindërit paguajnë në shkollë arsim dhe edukim, jo nota!
6. Rezultati i përgjithshëm i një klase dhe të mësuesve të saj përcaktohet me anë të rezultateve të punëve të jashtme krahasuese dhe të sjelljes sociale të klasës. Rezultati i përgjithshëm, i përbërë nga këto elementë: rezultatet në procesin mësimor, sjellja shoqërore dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme, .
7. Mungesat duhet të njoftohen tek drejtoria për t'i paraqitur nëpërmjet pikëve të kreditit NCTS (shiko IR 1.183. dt. 01.10.2008).
8. Detaje më të hollësishme për këtë përcaktohen nga drejtori i shkollës në një direktivë të veçantë.

Neni 8

Arsimi fillor

1. Mësuesit në klasat e I – III në bashkëpunim me prindërit, përcakton për nxënësit me vështirësi në të nxënë mënyra të posaçme të ndihmës për të, si
 - a) Përforcime
 - b) Hartimi dhe zbatimi i programeve individuale
 - c) Ndihma konkrete e prindërve
2. Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me mësuesit, organizon forma plotësuese për mbarëvajtjen e nxënëve në Arsimin fillor si;
 - a) Prindër vullnetarë në rolin e mësuesit ndihmës
 - b) Mësues ndihmës

- c) Ndhimesa e qeverisë së nxënësve (Nxënësit e rritur të ndihmojnë më të vegjëlit, organizimi i projekteve)
- d) Testime nga drejtoria e shkollës në lëndët: Gjuhë shqipe dhe matematikë gjatë vitit mësimor
3. Pas çdo testimi bëhet analiza në drejtorinë e shkollës, ku vihen në dukje anët pozitive dhe negative dhe caktohen detyrat plotësuese.
4. Mësuesi vlerëson nxënësit me përshkrim: gjatë vitit mësimor, në përfundim të disa periudhave të vitit mësimor, për:
 - a) Qëndrimin dhe aftësitë e përgjithshme të fëmijës si nxënës
 - b) Për objektivat kryesorë në fushat e të nxënit. Periudhat caktohen nga ministria.
5. Mësuesi i kryen vlerësimet sipas formatit që hartohet nga IZHA -ja dhe miratohet nga ministri.
6. Nxënësit e klasave I-III-të marin vlerësim përshkruar në periudhat tremujore: dhjetor, mars, qershor.
7. Vlerësimi përmbledhës realizohet një herë në vit pas vlerësimit të tretë përshkruar.
8. Vlerësimet do të jenë:
 - a) Arritje të pakënaqshme AKP
 - b) Arritje që kanë nevojë për përmirësim ANP
 - c) Arritje të kënaqshme AK
 - d) Arritje shumë të kënaqshme ASHK
 - e) Arritje të shkëlqyera ASH

Neni 9

Vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët

Vlerësimi periodik

1. Vlerësimi periodik kryhet në fund të një periudhe tremujore, për të evidentuar përparimin dhe arritjet e nxënësve me qëllim monitorimin dhe raportimin e tyre.
2. Vlerësimi periodik tremujor jepet nëpërmjet 3(tre) notave të veçanta për:
 - a) Vlerësimin e vazhduar me notë, që përmbledh shënimet e mësuesit të mbajtura në evidencat për periudhën tremujore.
 - b) Vlerësimin me notë, nëpërmjet testit ose detyrës përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
 - c) Vlerësim me notë të portofolit të nxënësit për periudhën tremujore.
3. Këto vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

Vlerësimi përfundimtar

1. Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë dhe me përshkrim referuar niveleve të arritjes.
2. Nota përfundimtare përfshin notat vjetore si më poshtë:
 - a) Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha tremujore (40 %)
 - b) Notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudha tremujore. (40 %)
 - c) Notën vjetore të vlerësimit të portofolit të nxënësit për tri periudha tremujore. (20%)
3. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:
 - a) përcaktohet nota vjetore e vlersimit të vazhduar (NVv)
 - b) përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NTP)
 - c) përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVP)
 - d) shumëzohet secila prej tyre me përqindjen përkatëse.
 - e) mbliidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë
 - f) Formula : Nota përfundimtare = (NVV x 0.4) + (NTP x 0.4) + (NVP x 0.2)
4. Përshkrimi i notës përfundimtare argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës)
5. Nxënësi nuk vlerësohet me note në:

- a) Përforcim dhe shërbim komunitar
 - b) Veprimtaritë e kurrikulës me zgjedhje të lire, në klasat VI – IX
 - c) Projektet kurrikulare në nivel shkolle ose të disa klasave, në gjimnaz
6. Nxënësi vlerësohet me notë:
- a) Në të gjitha lëndët, për klasat VI – IX
 - b) Në lëndët e kurrikulës bërthamë dhe ato me zgjedhje, për klasat VI deri në fund të arsimit parauniversitar
7. Në arsimin parauniversitar nxënësi vlerësohet për;
- a) Një ose disa tema mësimore të sapozhvilluara
 - b) Një ose disa kapituj të tekstit të nxënësit
 - c) Projekte ndërlyndore/lëndore dhe/ose punët e portofolit
8. Nxënësi vlerësohet në çdo lëndë të paktën një herë gjatë vitit shkollor për projekt ndërkurrikular/kurrikular. Orët mësimore për projektet u takojnë orëve të parashikuara në programin lëndor për përpunimin e njohurive.
9. Në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë nota vjetore lëndore përlylogaritet nga mësuesi i lëndës me formulën: $Nota\ vjetore\ lëndore = 0,4 \times M1 + 0,4 \times M2 + 0,2 \times M3$, ku M1, M2, M3 janë përkatësisht mesataret aritmetike të vlerësimit të vazhduar, vlerësimit me test dhe vlerësimit të portofolit /projektit të rumbullakosura me një shifër pas presjes.
10. Provimet me shkrim të nxënësve ruhen nga mësuesi për 1(një) vit shkollor dhe janë objekt inspektimi nga ISHA-ja, që shqyrton përputhjen me programin lëndor dhe objektivitetin e vlerësimit.
11. Vlerësimet e shkurtra(minitestet), nga fundi i orës mësimore, për rendimentin e orës mësimore ose të një kapitulli nuk vlerësohen me note.
12. Notat që marrin nxënësit në testime, të cilat nuk kryhen nga mësuesit lëndorë, nuk hidhen në regjister
13. Mesatarja vjetore njehsohet me një shifër pas presjes.

Neni 10

Vlerësimi i sjelljes së nxënësit

1. Sjellja e nxënësit vlerësohet me këto shkallë:
 - a) “Shumë mirë
 - b) “Mirë”
 - c) “Mjaftueshëm”
 - d) “Dobët”
2. Nxënësi vlerësohet me:
 - a) “shumë mirë”, kur nuk ndëshkohet gjatë vitit shkollor me ndonjë masë disiplinore
 - b) “mirë”, kur përfundon vitin shkollor me masë disiplinore të shlyer ose masa disiplinore e pashlyer nuk është ulje e notes në sjellje
 - c) “mjaftueshëm”, kur e përfundon vitin shkollor me ulje të notes në sjellje
 - d) “dobët”, kur vendos këshilli i disiplinës
3. Vlerësimi i sjelljes vendoset në regjistrin e klasës, dëftesën e klasës dhe amzë.

Neni 11

Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë

1. Vlerësimi në nivelin shkollor bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga shteti shqiptar.
2. Prindërit informohen rregullisht për rezultatet e fëmijëve nëpërmjet librezës së nxënësit.
3. Nxënësit do të vlerësohen në bazë të rezultateve, sjelljes, si dhe përfshirjes sociale të tyre.
4. Vlerësimi bëhet me anë të notave të mëposhtme:
 - a) 10 (dhjetë),
 - b) 9 (nëntë),
 - c) 8 (tetë),
 - d) 7 (shtatë),

- e) 6 (gjashtë),
 - f) 5 (pesë - nota më e ulët kaluese),
 - g) 4 (katër – notë pakaluese).
5. Në dëftesën e notave, me të cilën pajisen nxënësit në fund të një viti shkollor përlllogaritet edhe nota mesatare e nxënësit.
6. Mësimi dhe provimet duhet t'i përshtaten standardeve të të nxënësve.
- a) Vlerësimi me shkrim i nxënësve në gjimnaz bëhet me notë dhe pikë.
 - b) Mësuesi duhet të përdorë vlerësimin me pikë dhe pastaj t'i kthejë ato në notë. Në këtë rast nxënësi njoftohet për sistemin e pikëve.
 - c) Mësuesit e shkollës do të veprojnë sipas kësaj tablele:

Përqindja e pikëve	Nota
Nën 25%	4
25% - 40%	5
40% - 55%	6
55% - 70%	7
70% - 85%	8
85% - 95%	9
95% - 100%	10

7. Në çdo lëndë mësuesi së bashku me drejtorinë e shkollës duhet të zhvillojë të paktën 1 detyrë me shkrim (test) për çdo tremujor.
8. Gjatë vitit (tre-mujorit) nxënësi të vlerësohet:
- a) Për përgjigjet me gojë, pesha e përafërt 40%
 - b) Për përgjigjet me shkrim, pesha e përafërt 40%
 - c) Për arritjet në projektet kurrikulare dhe/ose punët e portofolit, pesha e përafërt 20%
 - d) Në përfundim të Maturës Shtetërore, maturanti duhet të pajiset edhe me një dëshmi të shërbimit komunitar

Neni 12

Matura

1. Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen sipas përcaktimeve dhe udhëzimeve të MASR.
2. Në vitin e fundit të gjimnazit nga PJ EDU do të zhvillohet një provim paramature gjatë muajit Janar dhe në muajin Prill sipas kushteve të Maturës Shtetërore. Përgatitja e paramaturës do të bëhet sipas udhëzimeve të DDP me specialistë të jashtëm. Kushtet e provimit do t'i përshtaten atyre të maturës shkollore. Rezultatet e arritura do të vlerësohen si provime të jashtme.

Neni 13

Publikimi i rregullores

1. Kjo Rregullore dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohen dhe të jenë të aksesueshëm elektronikisht dhe në formë të shtypur veçanërisht për personelin e shkollës dhe studentët.
2. Drejtoria është përgjegjës për të garantuar publikimin dhe aksesimin e Rregullores.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore për arsimin parauniversitar tek Nehemiah Gateway Albania dhe ndryshimet në të hyjnë në fuqi ditën që miratohet.

Lëshuar nga:

Elona Rira

Drejtoresh e shkollës Nehemia

Buçimas, më _____

Miratuar nga:

Herolinda Shkullaku

Drejtor Ekzekutiv N.G. Albania

Buçimas, më _____